



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 070-47698 dt. 02.11 2020

Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores Nr.12-320-19338, të datës 07.04.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nenit 49 dhe 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rekomandimit Nr.01-070/01-43907, të datës 02.11.2020, të Komisionit të Ankesave, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet Thirrja për Aplikim Nr.04-070/01-39148, e datës 25.08.2020, të Projektit për Furnizim me Mikser për Ushqim të Kafshëve 2.0M-3 – Blegtori, respektivisht Rekomandimi Nr.01-020-39475, i datës 02.10.2020, si dhe Vendimi Nr.01-020/04-39475, i datës 13.10.2020.
- II. Anulimi i Thirrja për Aplikim Nr.04-070/01-39148, e datës 25.08.2020, të Projektit për Furnizim me Mikser për Ushqim të Kafshëve 2.0M-3 - Blegtori, respektivisht i rekomandimit Nr.01-020-39475, të datës 02.10.2020, si dhe Vendimi Nr.01-020/04-39475, i datës 13.10.2020, bazohet në Rekomandimin e Komisionit të Ankesave, rrjedhimisht në vendosjen e kriterëve shtesë nga ana e komisionit vlerësuar, e qe nuk kanë qenë të parapara në shpalljen publike.
- III. Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural obligohet që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme, duke përcaktuar qartë kriteret që do të merren parasysh me rastin e vlerësimit, me qellim që mos të këtë asnjë devijim nga shpallja publike.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës
[Signature]
Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- DBPZHR-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.